[Shqiptarja.com]
Nipt:L12122018Q
Rr."Niko Pushkin" 3 kullat,kulla 2,kati i 2,Tirane
E-mail:vtheodhosi@yahoo.ca
cel: 0692053122

Prot....022 **Tiranë,më 07/10/2021**

V E N D I M
Datë 07.10.2021
i
Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "SHQIPTARJA.COM" SHPK

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë **"SHQIPTARJA.COM" SHPK,** e mbledhur sot më datë 07/10/2021 ora 12:00 në selinë e shoqërisë nën drejtimin e admnistratores Znj. Vilma Theodhos dhe me pjesëmarrjen e ortakëve të shoqërisë **"SHQIPTARJA.COM" SHPK,** ortaku shoqëria "FFM Group"sh.p.k, përfaqësuar nga administratorja Zj. Lindita Dode dhe ortaku Znj. Anila Basha përfaqësuar me prokurë të posacme me nr rep 3354 kol 1004 dt 07/10/2021 nga z. Gentian Tafilaj, pasi shqyrtoi rendin e ditës sikurse shënohet në njoftimin e asamblesë dt 28/09/2021, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";Ligjin Nr25/2018 per Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar , ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 për"Rregjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar), Ligjin nr. 131/2015, datë 26.11.2015 'Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe mbështetur në Statutin e Shoqërisë, **"SHQIPTARJA.COM" SHPK ;**

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të administratorit të datës 16/09/2021 për zmadhimin e kapitalit dhe ndryshimin e vlerave të kuotave dhe përqindjeve të ortakëve në kapitalin e shoqërisë " SHQIPTARJA.COM " SHPK shoqëruar me dokumentat në nënpikat më poshtë:

   a. Pasqyrat financiare të shoqërisë "SHQIPTARJA.COM" SHPK për periudhën 31.12.2020 deri më 31.05.2021.
   b. Pasqyra e financimeve me bankë të ortakut FFM Group SHPK.
   c. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto pas zmadhimit të kapitalit te shoqërisë "SHQIPTARJA.COM " SHPK duke ju referuar periudhës 31.12.2020 deri më 31.05.2021.
   d. Pasqyra e llogaritjes së pjesëmarrjes në përqindje për secilin ortak në kapitalin e shoqërisë pas zmadhimit të kapitalit të shoqërisë " SHQIPTARJA.COM" SHPK.

[Shqiptarja.com]
Nipt:L12122018Q
Rr."Niko Pushkin" 3 kullat,kulla 2,kati i 2,Tirane
E-mail:vtheodhosi@yahoo.ca
cel: 0692053122

2. Miratimin e raportit të datës 23/09/2021 së audituesit ligjor Euro-Audit, Consultancy.co me nipt K82403001L përfaqësuar nga audituesi ligjor z.Paqësor Qato me nr license 32 dt 13.01.2000 për verifikimin e vlerave të kontributeve të secilit ortak për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "SHQIPTARJA.COM" SHPK.

3. Zmadhimin e vlerës së kuotës së ortakut FFM Group SHPK nga 80 000 ALL (tetëdhjetë mijë lekë) në 4 228 796 ALL (katër milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë lekë) duke e cuar vlerën e kapitalit total të shoqërisë " SHQIPTARJA.COM " në 4 248 796 ALL (katër milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë lekë).

4. Ndryshimin e pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin total të ortakut FFM Group SHPK nga 80% (tetëdhjetë përqind) me vlerë 80 000 ALL (tetëdhjetë mijë lekë) në **99.53% (nëntëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e tre përqind) me vlerë 4 228 796 ALL (katër milion e dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë lekë).**

5. Ndryshimin e pjesëmarrjes në përqindje (%) në kapitalin total të ortakut Anila Basha nga 20% (njëzet përqind) me vlerë 20 000 ALL (njëzet mijë lekë) në **0.47% (zero pikë dyzet e shtatë përqind) me vlerë 20 000 ALL (njëzet mijë lekë).**

6. Ndryshimin e nenit 7-të të Statutit të shoqërisë " SHQIPTARJA.COM " SHPK në:
Kapitali themeltar dhe kuotat e tij zotërohen nga ortakët themelues si më poshtë:

- Shoqëria "FFM Group" SHPK – 1 kuotë që përfaqëson 99.53% të kontributit në kapitalin themeltar të shoqërisë me vlerë 4 228 796 lekë;

- Anila Basha – 1 kuote që përfaqëson 0.47% të kontributit në kapitalin themeltar të shoqërisë me vlerë 20 000 lekë.

7. Reflektimin e ndryshimeve të Statutit në rregjistrin tregtar lidhur me ndryshimin e vlerës së kuotave dhe përqindjeve (%) në pjesëmarrje.

8. Reflektimin e ndryshimeve përkatëse në librat kontabël të shoqërive FFM Group SHPK dhe "SHQIPTARJA.COM" SHPK.

9. Ngarkimin e administratorit të shoqërisë "SHQIPTARJA.COM" SHPK të depozitojë vendim dhe dokumentat e nevojshëm tek organet e kërkuara nga ligji.

10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

[Shqiptarja.com] TIRANË L12122018Q

FREE & FAIR MEDIA FFM GROUP L12121014C TIRANË

[Shqiptarja.com]
Nipt:L12122018Q
Rr."Niko Pushkin" 3 kullat,kulla 2,kati i 2,Tirane
E-mail:vtheodhosi@yahoo.ca
cel: 0692053122

ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria "FFM GROUP" SHPK
Përfaqësuar nga Administratorja
Znj. Lindita Dode (votoi pro për të gjitha pikat e rendit të ditës)

Znj.Anila Basha
Përfaqësuar nga z.Gentian Tafilaj (votoi kundër të gjitha pikat 1,2,3,4,5,6,7,8 dhe 9)

Prezent
Administratorja e Shqiptarja.com Znj. Vilma Theodhos